

Akti I themelimit i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"Uno Studio" shpk

AKTI I THEMELIMIT
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"Uno Studio" shpk

Sot, më datë 13.02.2024, ne, themeluesit,

1. Endri Bregu, atësia Almjand Bregu, shtetas shqiptar, me numer personal identifikimi I80717077U, e datëlindjes 17.07.1988, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
2. Erin Gjata, atësia Luan Qallija, shtetas shqiptar, me numër personal identifikimi I95625118R, I datëlindjes 25.06.1989, lindur ne Shkoder dhe banues në Tirane, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

1. Themelimi

Emri I shoqërisë është "Uno Studio" shpk. Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar. Shoqëria fiton personalitetin juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

2. Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- a) Ofrimin e shërbimeve të konsulencës financiare, shërbime të keshillimit financiar, shërbime të administrimit të taksave dhe shërbimeve të tjera administrative dhe organizative.
- b) Shërbime të regjistrimit të biznesit, shërbime të regjistrimit fillestar dhe ndryshime të tjera në regjistrin tregtar.
- c) Shërbime të tjera profesionale.

3. Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

4. Selia

Shoqëria ka selinë në rrugën "Gjergj Legisi", tek Fusha e Futbollit, Laprakë, Pallati nr 10, Kati 1, Shkalla 1, Tiranë. Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit te Shqipërisë.

Akti I themelimit i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"Uno Studio" shpk

Akti I themelimit i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"Uno Studio" shpk

5. Kapitali themeltar

Kapitali themeltar I shoqërisë është 50,000 (pesedhjetë mijë) Lekë dhe është I ndarë në 2 (dy) kuota, të përcaktuara si më poshtë:

- a) Ortaku themelues Endri Bregu, zotërues e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 25,000 (njetzet e pese mije) Lekë, që përbën 50% të kapitalit themeltar te shoqërisë.
- b) Ortaku themelues Erin Gjata, zotërues e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 25,000 (njetzet e pese mijë) Lekë, që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi I ortakëve mund te jetë në para ose në natyrë (pasuri të paluajtshme/ të luajtshme apo të drejta).

6. Administratori

Administratori I shoqërisë emërohet Erin Gjata, atësia Luan Qallija, shtetase Shqiptare, me numër personal identifikimi I95625118R, e datëlindjes 25.06.1989, lindur në Shkodër dhe banuese në Tiranë, me afat emërimi 5 vjecar, duke filluar nga data e emërimit.

7. Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë status dhe dispozitat e legjislacionit shqiptarë.


8. Mosmarrëveshjet


Të gjitha mosmarrëveshjet që mund te lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posacme të njohura nga ligji.

ORTAKET E SHOQERISE

ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"Uno Studio" shpk


Erin Gjata
(Emër, Mbiemër, Firma)


Endri Bregu
(Emër, Mbiemër, Firma)

Akti I themelimit i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar
"Uno Studio" shpk